Iniciativë për Dhënie Informacionesh Shpjeguese

(Ndryshime në SNK 7)

Ndryshime të SNK 7 *Flukset e mjeteve monetare*

Janë shtuar paragrafët 44A-44E dhe titujt përkatës. Është shtuar edhe paragrafi 60.

Ndryshime në detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare

44A **Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese që ju mundësojnë përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare, duke përfshirë edhe ndryshimet që rrjedhin nga flukset e mjeteve monetare dhe ndryshimet jo monetare.**

44B Në përpjekje për të përmbushur masën e nevojshme të kërkesave në paragrafin 44A, një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese për ndryshimet e mëposhtme në detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare:

(a) ndryshimet e flukseve të mjeteve monetare nga veprimtaria financiare;

(b) ndryshimet që rrjedhin nga marrja ose humbja e kontrollit të filialeve ose bizneseve të tjera;

(c) efektin e ndryshimeve të kursit të këmbimit valutor.

(d) ndryshimet ne vlerën e drejtë; dhe

(e) ndryshime të tjera.

44C Detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare janë detyrimet për të cilat flukset e mjeteve monetare ishin klasifikuar ose flukset e mjeteve monetare të ardhshme do të klasifikohen në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare si flukse monetare nga veprimtaritë financiare. Përveç kësaj, kërkesa për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafin 44A zbatohet gjithashtu, për ndryshimet në aktivet financiare (për shembull, aktivet që mbulojnë detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare) nëse flukset e mjeteve monetare nga këto aktive financiare janë përfshirë ose do të përfshihen në flukset e mjeteve monetare të ardhshme nga veprimtaritë financiare.

44D Një mënyrë për të përmbushur kërkesën për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafin 44A është kryerja e një rakordimi midis tepricës të çeljes dhe mbylljes në pasqyrën e pozicionit financiar për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare, duke përfshirë ndryshimet e identifikuara në paragrafin 44B. Kur një njësi ekonomike bën këtë rakordim të tillë, ajo duhet të sigurojë informacione të mjaftueshme për t'ju mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të lidhin zërat e përfshirë në këtë rakordim me pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare.

44E Nëse një njësi ekonomike jep informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 44A në kombinim me informacionet shpjeguese për ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e tjera, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë financiare veçmas nga ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e tjera.

Data e hyrjes në fuqi

...

60 *Iniciativa mbi Dhënie Informacionesh Shpjeguese* (Ndryshime në SNK 7), e publikuar në janar 2016, ka shtuar paragrafët 44A-44E. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që nisin nga data 1 janar 2017 e në vazhdim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Kur njësia ekonomike i zbaton këto ndryshime për herë të parë, nuk kërkohet të japë informacion krahasues për periudhat e mëparshme.